



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 7

Prishtinë, më 4 maj 2011, në orën 13: 00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT TË SHËNDETËSISË, TË PUNËS
DHE TË MIRËQENIES SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Sasha Gjokiq, Flora Brovina, Salihe Mustafa, Bahri Thaçi, Nazane Breca, Aurora Bakalli dhe Gëzim Kelmendi.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj - administratore e Komisionit, Enis Halimi – zyrtar i fushës për shëndetësi, Lejla Selimi – OSBE, Natyra Kasumaj – KDI dhe Ukë Gashi - Presidenca e Kosovës.

Mbledhjen e kryesoi: Fikrim Damka, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të 15. 04. 2011 dhe të 27. 04. 2011;**
- 3. Takim me ministrin e Shëndetësisë, Ferid Agani;**
- 4. Të ndryshme**

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

Kryesuesi, për shkak të pranisë së ministrit, propozoi që miratimi i procesverbaleve të bëhet në fund të mbledhjes.

3. Takim me ministrin e Shëndetësisë, Ferid Agani

Fikrim Damka - Tha se falënderojmë ministrin që iu ka përgjigjur ftesës sonë. Temat për të cilat është ftuar ministri kanë të bëjë me gjendjen e Sektorit Farmaceutik në Kosovë dhe me prioritetet e Ministrisë për vitin 2011. Për gjendjen në Sektorin Farmaceutik në Kosovë, e kemi pasur një takim me përfaqësuesit e Shoqatës Farmaceutike, me Doganat e Kosovës dhe me përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë.

Ferid Agani – Është kënaqësi t'i drejtohem Komisionit të Shëndetësisë në cilësinë e ministrit të Shëndetësisë. Bashkëpunimin me Komisionin e Shëndetësisë e konsideroj shumë të rëndësishëm. Temat e përzgjedhura janë preokupim edhe imi dhe i Ministrisë që unë e udhëheq. Situata në Sektorin Farmaceutik, në fushën legjislative, është e vështirë. Siç dihet, kjo fushë rregullohet me Ligjin për produkte dhe pajisje medicinale, që është plotësuar në tetorin e kaluar. Nga ekspertët është konstatuar se ky Ligj vetëm se e ka përqesuar situatën në Sektorin Farmaceutik. Pikërisht për këtë e kam vënë prioritet legjislativ ndryshimin e këtij Ligji për vitin 2011. Problem në këtë Sektor ka paraqitur edhe mungesa e banderolave, për shkak të planifikimit jo të mirë. Ky problem, pas një angazhimi të madh, është zgjidhur. Agjencia e Kosovës për Produkte Medicinale (AKPM) udhëhiqet nga një ushtrues detyre dhe kam kërkuar të shpallet konkursi për këtë pozitë. Grupi i punës është duke punuar për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për produkte dhe pajisje medicinale dhe, ashtu siç kam premtuar, deri më 1 qershor do të dorëzohet në Qeveri. AKPM-ja ka mungesë të kuadrit dhe ka nevojë të bëhet plotësimi dhe ristrukturimi, në mënyrë që ta kemi një agjenci, që është e gatshme t'i kryejë detyrat e veta. Ndërkohë i kemi angazhuar 6 inspektorë të rinj farmaceutikë në Agjenci, që tash i ka 12 inspektorë farmaceutikë. Problem paraqet Laboratori për Barnat. Po përpiqemi t'i angazhojmë të gjitha potencialet për funksionalizimin e tij. Po ashtu, kemi probleme me Divizionin Farmaceutik në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë. Furnizimi me barna për institucionet shëndetësore në të gjitha nivelet është shumë i dobët. Kjo ndodh për shkak të mungesës së mjeteve financiare, për shkak të planifikimeve të dobëta të institucioneve shëndetësore dhe për shkak të korrupsionit në institucionet farmaceutike, në të gjitha hallkat e zinxhirit që nga Divizioni Farmaceutik në Ministri e deri te institucionet shëndetësore. Sektori Farmaceutik është pika më e errët e sistemit shëndetësor. Problemet në veri të vendit edhe neve po na shkaktojnë probleme në furnizimin me barna. Barnat jepen pa përshkrimin e mjekut. Kjo nuk do të lejohet. Do të punojmë shumë që kjo praktikë të ndryshojë dhe për këtë nuk do të ketë fare tolerancë.

Jeton Shala - Kam trashëguar shumë probleme në Agjenci. Kemi probleme me planifikimin buxhetor për vitet e kaluara. Shpenzimi i buxhetit nuk është bërë në përputhje me planifikimin dhe kjo bie ndesh me Ligjin e financave publike. Në maj të vitit të kaluar, kur e kam marrë detyrën, kam pasur probleme financiare, për zgjidhjen e të cilave më ka mbështetur Ministria. Gjendje ishte e rëndë edhe në arkivin e agjencisë. Po ashtu kam trashëguar edhe borxhe të shumta të AKPM-së. Për mallra dhe për shërbime Agjencia i ka pasur vetëm 69 mijë euro. Kam kërkuar të bëhet auditimi i jashtëm dhe i brendshëm. Në këtë proces janë evidentuar parregullsi të mëdha. Departamenti i Autorizimit Marketingut, në vitin 2010, duke u bazuar në ligj, edhe pse me numër të pamjaftueshëm të stafit, ka arritur të bëjë evalvimin e dosjeve, dhënien e lejeve për import nga shtetet e BE-së, si dhe dhënien e certifikatave për shtetet e rajonit dhe të BE-së. Në vitin 2010 kemi pasur 423 produkte medicinale me origjinë nga BE-ja, 61 produkte të rajonit dhe 134 produkte vendore, të kontrolluara dhe të evalvuara. Kemi edhe 389 produkte, që janë në pritje

për shkak se nuk e kanë të kompletuar dosjen. Me rritjen e numrit të punëtorëve në këtë Departament kemi arritur t'i heqim nga lista e pritjes të gjitha produktet që kanë qenë aty nga viti 2009 dhe e kanë pasur dosjen e kompletuar. Numri i produkteve që kanë certifikata 5-vjeçare është 1227. Një kompani mund t'i ketë 100 produkte të regjistruara brenda një viti. E kemi përgatitur aplikacionin për ricertifikim, që më parë nuk është praktikuar. Kam punuar për ngritjen e efikasitetit të administratës në Departamentin e Licencimit. Po ashtu, me qëllim të eliminimit të mundësive për keqpërdorime dhe për korrupsion, janë modifikuar aplikacionet për licencim dhe janë shpallur në faqe të internetit. Komunikimet me palët janë mbajtur në mënyrë korrekte. Këto masa kanë pasur efekt të mirë, sepse atmosfera e punës është përmirësuar. Presioni mbi punëtorët ka rënë, efikasiteti në punë është rritur, lejet e importit janë përgatitur brenda 24 - 48 orëve, gabimet gjatë përgatitjes së këtij dokumentacioni janë minimizuar dhe palët kanë qenë shumë të kënaqura. Problemi i banderolave është i trashëguar nga vitet e mëparshme. Çmimi i tyre ka qenë i lartë dhe nuk kemi mundur t'i blejmë nga kategoria e mallrave dhe e shërbimeve. Tash kemi banderola 10 herë më të lira.

Flora Brovina – Çfarë është bashkëpunimi juaj me prodhuesit farmaceutikë vendorë dhe cilat ka qenë vërejtjet konkrete të Agjencisë gjatë procesit të hartimit të Ligjit për produkte medicinale?

Jeton Shala - Nuk janë marrë parasysh vërejtjet që i kam paraqitur me rastin e hartimit të ligjit. Ligji ka mangësi në shumë definicione, që duhet të përmirësohen. E kemi nënshkruar një kontratë me një program gjerman në vlerë 1 milion euro. Me partnerët gjermanë e kemi arritur versionin, si duhet të jetë ligji, në mënyrë që të mos kemi probleme.

Time Kadriaj - I mbështes kolegët e mi, mjekë, që sot po protestojnë kundër uljes së të ardhurave për kujdestaritë. U pa se është bërë identifikimi i problemeve në Sektorin Farmaceutik. Çfarë zgjidhje keni bërë për banderolat? Çka keni ndërmarrë për funksionalizimin më të mirë të Inspektoratit Shëndetësor dhe të Inspektoratit Farmaceutik? Nga Shoqata Farmaceutike jemi njoftuar se numri i barnave të regjistruara është i vogël. Çka keni ndërmarrë për zgjidhjen e këtij problemi? Çka keni ndërmarrë për përmirësimin e furnizimit me barna nga lista esenciale dhe sa do të ketë barna nga grupi i citostatikëve? Çka do të bëhet me barnat me afat të skaduar?

Salihe Mustafa – Ju përmendët dobësitë në divizionin farmaceutik në Ministri. A keni ndërmarrë konkretisht diçka për rregullimin e gjendjes në këtë divizion? A keni ndërmarrë diçka konkrete dhe a e keni ndërmend të ndërmerrni diçka për çështjen e barnave? Qytetarët e Gjilanit pyesin me shqetësim se çka do të bëhet me barna me afat të skaduar, që gjinden si në Spitalin Rajonal dhe në një lokacion tjetër në Komunën e Gjilanit? A keni ndonjë plan konkret lidhur me këtë problematikë? Në Ligjin e shëndetësisë thuhet se Mitrovica Veriore, Graçanica dhe Shtërpca do kenë kompetenca të vetjake për kujdesin shëndetësor dytësor. A ka mundësi të na sqaroni më shumë rreth kësaj çështjeje?

Aurora Bakalli - Më shqetëson fakti i reduktimit të të ardhurave nga ndërresa e natës për mjekët dhe infermierët, sidomos në Qendrën Emergjente. Dua të ngre çështjen e mospagesës së rritjes së pagave për muajt janar dhe shkurt për punëtorët shëndetësorë. Çështje tjetër që dua të ngre është ajo e subspecializimeve. Në projektligjin e ri të shëndetësisë specifikohet shumë mirë kjo çështje, por ajo që dua ta di, është: Sa duhet të presim për një gjë të tillë? A ka nevojë të pritët për këtë gjë

derisa të miratohet ligji? Do të ishte mirë për këtë çështje të bëhej një harmonizim më i mirë me Shqipërinë, sepse me kolegët që kanë specializuar atje ka pasur ca probleme sa i përket titujve të tyre dhe titujve që janë marrë këtu. Sa i takon farmacisë, më intereson të di se a ka ndërruar gjendja në terren? Ajo për të cilën unë angazhohem është eliminimi i monopoleve, sepse ato krijojnë kosto të lartë për barnat. Sa barnatore në enklava janë inspektuar për gjetjen e barnave të kontrabanduara?

Nazane Breca - Shëndetësia, bazuar në buxhetin e ndarë, edhe në këtë vit nuk duket të jetë prioritet i Qeverisë. Keni thënë se do të gjeni burime alternative për buxhetin e shëndetësisë. Dua të di më shumë rreth këtyre burimeve alternative. Sa i takon Sektorit të Farmacisë, a keni menduar ta shkurtoni listën esenciale, që pastaj atë ta përmbushni plotësisht?

Bahri Thaçi - Te qytetarët ekziston shqetësimi për listën esenciale. Kjo listë do t'i mbështetë me barna të sëmurët kronikë, që kanë nevojë për barna gjatë tërë jetës, si: citostatikët, insulina etj? Dua të di më shumë rreth odës farmaceutike të Kosovës, sepse e dimë se farmacistët janë të interesuar ta themelojnë këtë odë.

Flora Brovina - Jam e interesuar të di cilat janë prioritetet e reformimit në fushën e shëndetësisë, që ju e keni proklamuar kur jeni emëruar në pozitën e ministrit. Për reforma, ju duhen informatat e duhura. Si do t'i bëni reformat kur nuk e kemi sistemin e informimit shëndetësor?

Ferid Agani - Jam i gatshëm t'i përgjigjem Komisionit sa herë që e konsideroni të nevojshme. Sektori i shëndetësisë nuk duhet të jetë arenë e ballafaqimit politik. Sa i takon grevës së punëtorëve shëndetësorë, ata plotësisht kanë të drejtë. Bëhet fjalë për Ligjin e punës, me të cilin janë barazuar të gjithë punëtorët. Për punëtorët shëndetësorë duhet të parashihen pagesa të tjera, më të larta, krahasuar me punëtorët e tjerë. E kam themeluar grupin që përbëhet nga Ministria dhe nga Federata e Shëndetësisë, që po punon për hartimin e marrëveshjes kolektive, që kemi të drejtë ta bëjmë në bazë të Ligjit të punës. Me këtë marrëveshje kolektive do ta rregullojmë edhe këtë çështje. Po ashtu, është duke u hartuar udhëzimi administrativ, për pagesën e punëtorëve shëndetësorë dhe për rrezikshmërinë në punë. Sa u përket banderolave, vitin e kaluar nuk kanë qenë të planifikuara. Për vitin tjetër do ta bëjmë planifikimin me kohë. Shtrohet çështja a është e nevojshme që në çdo produkt të vendoset banderola? Ndoshta do të ishte mirë të bëhet aplikimi selektiv i banderolave, pra vetëm për disa barna të caktuara, kurse për barnat e tjera të vendosen numrat serikë.

Shumë pozita në kuadër të Ministrisë janë me ushtrues detyre. Kjo paraqet problem, sepse ushtruesi i detyrës është më i kufizuar në ushtrimin e detyrave. Kemi bërë hapa konkretë për rregullimin e kësaj çështjeje. Kam bërë kërkesë në Ministrinë e Financave për rritjen e numrit të inspektorëve për 20 veta për vitin 2011, por një gjë e tillë ka qenë e pamundur të bëhet, për shkak të kufizimeve, që janë caktuar për punësime të reja. Është fakt që barnat e regjistruara mungojnë. Procedurat e regjistrimit të barnave janë delikate. Ka pasur vonesa të mëdha në këtë fushë dhe krejt përgjegjësia i ka rënë Agjencisë. Tash e kemi një angazhim të sforcuar në këtë drejtim. Sipas raportit farmaceutik të Ministrisë, gjendja e stokut të barnave është e mirë. Sipas tij ekzistojnë rreth 70 % e barnave dhe e materialit tjetër. Sa i përket listës esenciale të barnave është një hendek i madh midis asaj që e ka Ministria dhe asaj që e kanë institucionet shëndetësore. Tash është në funksion një program softuerik për çështjen e shpërndarjes së barnave. Po përgatiten kontratat kornizë me furnizuesit. Kjo do ta mundësojë furnizimin më fleksibil me barna.

Sa u përket barnave me afat të skaduar, jemi duke e përgatitur një marrëveshje me Ministrinë e Mjedisit për asgjësimin e tyre sipas standardeve dhe kjo do të zgjidhet brenda disa muajve.

Do ta decentralizojmë furnizimin me barna. Shkurtimi i listës esenciale është mënyrë e mirë për ta rritur efikasitetin, në mënyrë që kjo listë të përmbushet plotësisht. Sa u përket kompetencave të komunave të përmendura për kujdesin shëndetësor dytësor, grupi i hartimit të ligjit është i mendimit që çështja e kujdesit shëndetësor dytësor të mos jetë çështje ekskluzive e Ministrisë së Shëndetësisë, posaçërisht me modelin e sistemit shëndetësor, që po synojmë ta ndërtojmë. Me këtë model, secilës komunë do t'i jepet e drejta që, nëse ka mundësi, ta themelojë dhe ta mbajë financiarisht institucionin e kujdesit shëndetësor dytësor. Ekuivalentimi i subspecializimeve mund të bëhet edhe para se të miratohet ligji. Ky mund të bëhet me udhëzim administrativ. Jemi duke punuar për ndryshimin e 4 udhëzimeve administrative. Pajtohem që këtë çështje ta harmonizojmë me Shqipërinë.

Duhet të fillojmë ta ndalojmë marrjen e barnave pa përshkrimin e mjekut, sepse në këtë mënyrë rrezikohet shëndeti i popullatës. Me këtë do të fuqizohet roli i mjekëve familjarë.

Jeton Shala - I kemi pasur 3 aksione të Inspektoratit, në të cilat janë mbyllur disa barnatore. Në enklava nuk kemi bërë inspektime të barnatoreve.

Ferid Agani - Nuk do të ketë diskriminim të asnjë natyre dhe inspektoratet, duke vepruar gradualisht, do ta kryejnë punën e tyre pa asnjë dallim. Oda farmaceutike është një prej prioritetëve. Po ashtu do të themelohen edhe oda e mjekëve dhe oda e infermierëve. Sa i takon stimulimit të prodhuesve vendorë të barnave, kam zhvilluar takime me këta ndërmarrës, por ende nuk e kemi një strategji për një gjë të tillë. Ne duhet ta zhvillojmë një strategji të tillë, sepse është mirë të stimulohen prodhuesit vendës. Prioritetet e reformës fillojnë që nga ndryshimi i organogramit të Ministrisë së Shëndetësisë, sepse shumë gjëra në Ministri nuk janë në funksion të një efektiviteti më të mirë të punës. Organogrami i ri i Ministrisë është duke u përgatitur dhe së shpejti do të përfundojë.

Është duke u punuar në tri ligje, si: Ligji i shëndetësisë, Ligji i produkteve medicinale dhe Ligji për sigurime shëndetësore. Do të formohet shërbimi kombëtar i shëndetësisë, që do të jetë një organizim i ri juridik dhe pronësor i sistemit shëndetësor. Procesi i themelimit të tij do të nisë në bazë të Ligjit për ndërmarrjet publike, por funksionimi i tij do të jetë ndryshe nga ndërmarrjet e tjera publike, sepse në shëndetësi ka standarde të tjera dhe ka nevoja specifike. Themeli i këtij shërbimi, përveç të tjerash, do ta ndihmojë Qeverinë ta zgjidhë problemin me FMN-në. 12 mijë punëtorë shëndetësorë hiqen nga pagesa prej Qeverisë dhe ata do të paguhet nga Agjencia e Sigurimeve Shëndetësore, që i kontraktin shërbimet me shërbiminkombëtar të shëndetësisë, që do ta ketë çmimoren e shërbimeve që i ofron. Pastaj me buxhetin që mbetet mund të realizohen projekte të ndryshme në lëmin e shëndetësisë, si: mjekët e rinj, specializimet, inspektoratet etj. Shërbimi kombëtar i shëndetësisë do të zgjidhë shumë probleme në shëndetësi, për të mos thënë se do t'i zgjidhë të gjitha problemet. Kam biseduar edhe me ministrin dhe ish-ministrat në Shqipëri. Edhe ata janë pajtuar se ky sistem i funksionimit është shumë i mirë. Kështu do të mundësohet një lloj depolitizimi i sistemit shëndetësor.

Nazane Breca - A është i bazuar ky model në modelin National Health Services të Britanisë së Madhe?

Ferid Agani - Britania është model që synojmë ta imitojmë, por duhet të përshtatet për kushtet tona.

Aurora Bakalli – Është mirë të bëhet një ndarje e qartë midis sektorit publik dhe sektorit privat shëndetësor.

Ferid Agani - Po të bëhej kjo ndarje, situata do të ishte shumë më e pastër, por është bukur e vështirë të arrihet kjo. Me këtë model do të stimulohen të punojnë sa më shumë në sektorin publik, sepse do të paguhet mbi bazën e punës së tyre. Sistemi i informimit shëndetësor është kyç për çdo gjë. Ne nuk kemi të dhëna për shumë çështje dhe për shumë sëmundje. Është një projekt i Luksemburgut prej 1.6 milion euro, që parashihet të investohen për sistemin e informimit shëndetësor. Duhet të jetë një sistem i fuqishëm shëndetësor, që do t'i përfshinte edhe sektorin publik edhe atë privat, në mënyrë që të parandalohen keqpërdorimet e ndryshme që mund të ndodhin.

Oda e profesioneve shëndetësore do të themelohet nën mbikëqyrjen gjermane. Në vjeshtë do ta themelojmë këshillin nismëtar për këtë odë me 4 urdhra: mjekë, stomatologë, infermierë dhe farmacistë.

Time Kadriaj - A mendoni se vetëm me organogram të ri të Ministrisë do t'i zgjidhni problemet?

Nazane Breca - A do të kalojnë spitalet rajonale në kompetencë të komunave dhe a do të rregullohet me ligj kjo çështje?

Ferid Agani - Me organogram të ri do të ketë reduktim të kompetencave të sekretarit të përhershëm. Me ligj do të përcaktohet e drejta e komunës të themelojë institucion të kujdesit shëndetësor dytësor, por kjo do të bëhet me vendim të Qeverisë dhe me propozim të Odës së Profesioneve. Burimet alternative do të jenë nga ata që nuk janë të punësuar në sektorin joformal të punësimit. Më konkretisht, në Kosovë regjistrohen rreth 300 mijë automjete. Kjo tregon se ka numër të madh të të punësuarve në sektorin joformal. Në të ardhmen, qytetari do të mund t'i shfrytëzojë shërbimet pa pagesë, vetëm nëse do ta ketë kartelën e sigurimit shëndetësor nga asistenca sociale ose kartelën e sigurimit shëndetësor të paguar si premium. Ka shumë të siguruar në kompanitë private. Supozohet se janë rreth 50 mijë të tillë.

Flora Brovina - Së shpejti do ta merrni një kërkesë nga gratë parlamentare, që të mundësohet për të gjitha gratë një skринing për kancerin e qafës së mitrës dhe futjen e vaksinimit si metodë e parandalimit të kësaj sëmundjeje.

Ferid Agani - Do ta përfshijmë në ligj skринingun për kancerin e qafës së mitrës dhe për kancerin e gjirit. Jemi i vetmi vend ku doganohen edhe vaksinat. Kam kërkuar në Qeveri që një pjesë e akcizës për duhanin të shkojë në buxhetin për shëndetësi.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të 15. 04. 2011 dhe të 27. 04. 2011

Kryesuesi konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale i miratoi procesverbalet e mbledhjeve të 15. 04. 2011 dhe të 27. 04. 2011.

4. Të ndryshme

Time Kadriaj - Dje kemi qenë në Pejë për mbikëqyrjen e Ligjit për duhanin. Jemi pritur nga kryetari i Komunës, nga drejtori i Inspektoratit, nga drejtori për shëndetësi dhe nga drejtori i Spitalit Rajonal. Drejtori i Spitalit e kishte filluar një fushatë të vetëdijesimit për ndalimin e pirjes së duhanit në Spitalin Rajonal dhe kishte bërë disa statistika për ata që e pinë duhanin në kolektivin e Spitalit Rajonal të Pejës.

Flora Brovina - Do të ishte mirë ta mbajmë mbledhjen e Komisionit para orës 13:00, sepse nuk po mund të marrim pjesë në mbledhjen e grupit parlamentar.

Mbledhja përfundoi në orën 15:40.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka